



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ENUAR V MERKO
ZYRA PËRMBARIMORE E.G BAILIFF SERVICE

Adresa: Rr. "Themistokli Gërmenji", Pallati "Ambasador 1", Kati 2, Tiranë Cel +355 67 20 27 580, e-mail: enuar.merko@gmail.com



Nr. 8663 . Prot

Tiranë më 19.11.2020

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në Tiranë sot më datë 19.11.2020

Unë **Enuar V MERKO** Përmbarues Gjyqësor Privat me Liçensë Nr. 123 pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të Urdhërit Ekzekutimit, Vendimi Nr.923 Akti, datë 24.07.2015 i Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

KONSTATOVA

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) Tiranë, në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur pranë Zyrës Përmbarimore E.G BAILIFF SERVICE me Përmbarues Gjyqësor Enuar V MERKO, kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Vendim Dënim me Gjobë Nr. 1, datë 07.03.2014 të Grupit të Inspektorëve të AMA-s, palë dhe objekt:

- **Kreditor** : Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) Tiranë
- **Debitor** : Josif Shegani PF me NIPT L14715601A,
i autorizuar për subjektin kabllor Tv Lin
- **Me objekt** : Pagim Gjobe

Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv, Vendim Dënim me Gjobë Nr. 1, datë 07.03.2014 të Grupit të Inspektorëve të AMA-s.

Me vendim të Përmbaruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titulli Ekzekutiv, Vendim Dënim me Gjobë Nr. 1, datë 07.03.2014 të Grupit të Inspektorëve të AMA-s ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte për ekzekutimin e Titulli Ekzekutiv, Vendim Dënim me Gjobë Nr. 1, datë 07.03.2014 të Grupit të Inspektorëve të AMA-s, duhet të kryhet bllokimi mbi të gjitha



aksionet e zotëruara nga pala debitore Josif Shegani PF me NIPT L14715601A dhe Josif Nestor Shegani i dtl. 21.01.1952 me qëllim shlyerjen e detyrimit.

Nga sa më sipër si dhe mbështetur në nenin 527 të Kodit Proçedurës Civile dhe Ligjit nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJMË

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore Josif Shegani PF me NIPT L14715601A dhe Josif Nestor Shegani i dtl. 21.01.1952 për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Vendim Dënim me Gjobë Nr. 1, datë 07.03.2014 të Grupit të Inspektorëve të AMA-s.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT
ENUAR V MERKO**

